

VENDIM
Nr.508, datë 8.8.2007

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.632, DATË 18.9.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE" PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË, FEMRA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 5 e 8, pika 3, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim e kjo shtesë:

1. Në shkronjën "c", pika 4, shprehja "tetë pagave" zëvendësohet me "katër pagave".

2. Në pikën 6 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Nëse punëdhënësi bën zgjidhje, të menjëhershme e të pajustificuar, të kontratës së punës për punëmarrësin, e vërtetuar kjo me vendim gjyqate, të formës së prerë, është i detyruar të kthejë të gjithë financimin e marrë, nga datat e dhënies së tij, së bashku me interesat, sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha